

Instituti për Studime të Avancuara GAP

## Letërnjoftimi i Komunës së Vitisë 2012

Shtator 2012

*“Letërnjoftimi i Komunave”* është projekt i Institutit GAP i cili vlerëson qeverisjen komunale dy vite pas zgjedhjeve lokale të vitit 2009. Ky projekt është implementuar në bashkëpunim me Rrjetin Ballkanik për Gazetari Hulumtuese (BIRN) dhe Qendrën e Trajnimeve dhe Burimeve për Avokim (ATRC). Rezultatet e hulumtimeve të GAP për qeverisjen komunale janë debatuar me kryetarët e komunave në emisionet “Jeta në Kosovë”.

## Përmbajtja

Përmbledhje ekzekutive.....	3
1. Problemet në Komunën e Vitisë .....	5
2. Performanca buxhetore e Komunës së Vitisë .....	6
3. Investimet kapitale.....	10
4. Aktivitetet e prokurimit publik 2010 - 2011 .....	12
5. Administrata e Komunës së Vitisë .....	14
6. Arsimi në Komunën e Vitisë .....	16
7. Shëndetësia në Komunën e Vitisë.....	17
8. Transparenca .....	18
9. Përmbushja e premtimeve të fushatës zgjedhore 2009.....	19
10. Burimet .....	22

## Përmbledhje ekzekutive

Komuna e Vitisë qeveriset nga persona të ardhur nga Partia Demokratike e Kosovës (PDK). Kryetar i Komunës është z. Nexhmedin Arifi. Ai e ushtron këtë pozitë nga viti 2007 kur është zgjedhur për Kryetar të Komunës së Vitisë në mandatin e parë dy vjeçar, ndërsa mandatin e dytë për katër vite e ka fituar në zgjedhjet e vitit 2009. Z. Arifi para se të fitoj pozitën e Kryetarit të Komunës, ka udhëhequr resorë të rëndësishëm brenda Komunës së Vitisë. Gjatë periudhës 2000-2002, ai ka qenë zëvendëskryetar i Komunës së Vitisë, ndërkaq në periudhën 2003-2006 ka qenë menaxher i Shtëpisë së Kulturës. Edhe në zgjedhjet e vitit 2007 edhe në ato të vitit 2009, pozitën e Kryetarit të Komunës e ka fituar pas mbajtjes së balotazhit. Në zgjedhjet e fundit të vitit 2009, z.Arifi është përballur në balotazh me kundër kandidatin Sokol Haliti nga Lidhja Demokratike e Dardanisë (LDD), duke fitur 55.2% të votave.

Pak muaj pas nisjes së mandatit të dytë në pozitën e kreut të Komunës së Vitisë, z. Arifi ballafaqohet me pakënaqësi brenda degës së PDK-së në Viti, nga ku edhe përjashtohet si sekretar dhe anëtar i kësaj dege. Kjo ka ndikuar edhe në nivelin qeverisës të komunës, ngase në Kuvendin Komunal disa anëtarë të PDK-së i favorizojnë politikat e degës së PDK-së dhe jo politikat e ekzekutivit komunal. Edhe ekzekutivi i udhëhequr nga Kryetari i Komunës, Nexhmedin Arifi ka ndërmarr hapa për t'i përjashtuar nga pozitat kyçe personat që janë rreshtuar përkrah politikave të degës së PDK në Viti. Kësisoj është përjashtuar nënkryetari i komunës Halim Halili dhe Drejtoresha e Drejtorisë për Buxhet dhe Financa, Selvije Rexhepi. Aktualisht nënkryetar i komunës është Abdyl Bajrami i cili në kohën e zgjedhjeve të fundit nacionale ka kandiduar si këshilltar komunal nga radhët e AKR-së.

Kuvendi Komunal i Vitisë përbehet nga gjithsejtë 26 anëtarë. PDK nuk e ka shumicën e vendeve. Më së shumti vende në Kuvendin Komunal në Viti ka LDD me gjithsejtë shtatë anëtarë, pastaj renditet PDK me gjashtë anëtarë, AAK me pesë, LDK me katër, AKR me tre dhe një anëtarë vjen nga subjekti politik PDKI. Në ndërkohë, disa anëtarë të LDD-së kanë kaluar në LDK.

Dega e PDK-së në Viti, menjëherë pas zgjedhjeve lokale të vitit 2009, pati arritur marrëveshje me AKR dhe AAK për të bashkëqeverisur Komunën e Vitisë, dhe kësisoj ky subjekt politik e pati krijuar shumicën e vendeve të nevojshme në Kuvend të Komunës me gjithsejtë 14 anëtarë (PDK, AKR dhe AAK). Zhvillimet e mëvonshme brenda degës së PDK në Viti e patën shtyrë kryetarin e degës së PDK-së në Viti që të shpall të prishur marrëveshjen me AKR dhe AAK për të bashkëqeverisur komunën. Kjo ka pasur vetëm efekt politik, por jo edhe praktik, ngase ndarja e resorëve të komunës në bazë të marrëveshjes paraprake mes PDK, AKR dhe AAK ka vazhduar të mbetet funksionale.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal të Vitisë vjen nga AAK (Skënderbe Habibi), ndërsa zëvendëskryesuesi nga AKR (Enver Ukshini). Ligji për Vetëqeverisje Lokale parasheh zëvendëskryesues në Kuvendet Komunale vetëm në ato raste kur 10% e popullatës në atë komunë i takon një komuniteti jo shumicë.<sup>1</sup>

Në bazë të marrëveshjes për bashkëqeverisjen e komunës së Vitisë mes PDK, AAK dhe AKR, kjo e fundit nuk ka marr asnjë drejtori për ta udhëhequr, përderisa AAK udhëheq me tri: Drejtorinë për Kulturë, Drejtorinë për Shërbime Publike dhe me Drejtorinë e Gjeodezisë. PDK udhëheq shtatë drejtori: Drejtoria e Arsimit, Drejtoria e Urbanizmit, Drejtoria e Inspektionit, Drejtoria e Shëndetësisë, Drejtoria e Administratës, Drejtoria për Buxhet dhe Financa dhe Drejtoria e Bujqësisë.

Tensionet dhe fraksionet e krijuara në degën e PDK-së në Viti, e kanë ngadalësuar dhe vështirësuar progresin në këtë komunë. Kjo situatë është rënduar edhe më shumë nga hetimet për korrupsion ndaj udhëheqësve të komunës së Vitisë nga ana e Njësisë për Krime Ekonomike të Policisë së Kosovës, si dhe akuzës së ngritur nga ana e Prokurorisë së Qarkut në Gjilan duke akuzuar Kryetarin e komunës për shpërdorim të pozitës zyrtare.<sup>2</sup> Sipas të dhënave të siguruara nga zyrtarë të komunës së Vitisë, objekt hetimi, përveç tjerash, janë dyshimet për keqpërdorime lidhur me projektin e dështuar të ndërtimit të një pende në lumin Morava, me ç'rast, duke i'u shmangur të gjitha rregullave, Kryetari i Komunës urdhëron pagesën prej 60.000 eurove për një firmë zvicerane që rezulton të jetë fiktive. Këtë rast tashmë nuk e fsheh as Nexhmedin Arifi, duke thënë se "ka pasur qëllim të mirë, por është mashtruar". Vendimi për ndarjen e këtyre mjeteve ka kaluar edhe nëpërmjet kuvendit komunal.

Gjatë qeverisjes në dy vitet e fundit janë hasur parregullsi të shumta në sferën e punësimeve në fushën e administratës komunale, arsim dhe shëndetësi. Nuk janë të pakta rastet kur drejtpërdrejt është kritikuar Kryetari i Komunës nga opozita dhe shoqëria civile, për përfshirjen e tij në rastet e përjashtimeve nga puna apo në rastet e punësimeve të reja.

Instituti GAP ka vlerësuar ecurinë e përgjithshme të zhvillimeve në këtë komunë, duke numëruar problemet, mangësitë dhe vështirësitë nga fusha e investimeve kapitale, mënyra e shfrytëzimit dhe shpenzimit të parëse publike, shkalla e transparencës, prokurimi publik, funksionimi i administratës dhe ekzekutivit. Po ashtu, janë vlerësuar ndaras të gjitha premtimet e dhëna nga Kryetari i komunës gjatë fushatës zgjedhore të vitit 2009 dhe ecuria e deritanishme e realizimit të tyre.

---

<sup>1</sup> Neni 54 i Ligjit për Vetëqeverisje Lokale. Burimi:

[http://kuvendikosoves.org/common/docs/ligjet/2008\\_03-L040\\_al.pdf](http://kuvendikosoves.org/common/docs/ligjet/2008_03-L040_al.pdf)

<sup>2</sup> Koha Ditore. Aktakuzë ndaj udhëheqësve të Komunës së Vitisë. 7 maj 2012. Burimi:

<http://www.koha.net/?page=1%2C13%2C98444>

## 1. Problemet në Komunën e Vitisë

Mungesa e rrjetit të kanalizimit dhe ujësjellësit, mos asfaltimi i rrugëve lokale, vjetërsimi dhe bllokimi i gypave të rrjetit të të reshurave atmosferike, cilësia jo e duhur e ujit të pijes, mos zgjerimi i rrjetit të ndriçimit publik, dëmtimi dhe vjetërsimi i objekteve shkollore, mos rregullimi i shtretërve të lumenjëve, llogariten si problemet më të mëdha më të cilat përballën qytetarët e komunës së Vitisë.

Pjesa dërmuese e fshatrave të Vitisë janë pa sistem të kanalizimit. Gjendja paraqitet më e rënduar në fshatrat Binqë, Beguncë, Smirë, Stubell, Radivojcë dhe në fshatin Sadovinë. Banorët e këtyre zonave u kanë drejtuar disa herë kërkesa dhe ankesa autoriteteve lokale me qëllim që këta të fundit të ndër marrin masa në zgjidhjen e këtij problemi. Deri më tani nuk është vërejtur ndonjë hap konkret i përgjegjëseve të komunës së Vitisë në këtë drejtim.

Gjendja e ngjashme paraqitet në këtë komunë edhe nga mungesa e përfshirjes së të gjitha zonave të banuara në sistem të ujësjellësit. Pothuajse të gjitha fshatrat janë pa sistem të ujësjellësit. Në ato zona ku është i shtrirë ujësjellësi, kapaciteti i ujit është i pamjaftueshëm dhe reduktimet janë mjaft të shpeshta. Gjatë dy viteve të kaluara, autoritetet lokale kanë marrë disa nisma për hapjen e puseve të ujit, nisma këto që do të duhet shtrirë në të gjitha zonat e Vitisë. Besohet se kjo nismë do të ndikoj në zbutjen e gjendjes së rënduar nga mungesa e ujit të pijes.

Komuna e Vitisë është në mesin e komunave të pakta që nuk ka arritur të ketë një shtrirje të gjerë të asfaltimit të rrugëve lokale, veçmas në periferi të qytetit dhe në fshatrat e kësaj ane. Deri tani komuna ka arritur t'i asfaltoj vetëm rrugët kryesore, por jo edhe ato dytësore. Prioritet në asfaltimin e rrugëve u është kushtuar zonave urbane dhe më pak atyre rurale ku hasen rrugë disa kilometërshe të parregulluara.

Banorët e Komunës së Vitisë, veçmas ata në zonat urbane, në vitet e fundit po përballen edhe me vërshime, pas të reshurave atmosferike. Kjo vije nga pamundësia e gypave atmosferik për të pranuar sasinë e ujërave. Nuk është vërejtur ndërmarrja e ndonjë mase nga ana e autoriteteve lokale në parandalimin e këtyre rasteve në të ardhmen. Dëmtimet e shtëpive dhe bizneseve nga vërshimet kanë qenë evidente, ndërsa dëmshpërblimi nga ana e komunës për këto raste ka munguar.

Kontaminimi i rrjedhjes së lumenjve nga derdhja e kanalizimeve dhe hedhja e mbeturinave paraqet problem madhor për qytetarët e kësaj komune. Territorin e Vitisë e përshkon lumi Morava e Binçes dhe lumi Letnica. Kundërmimi i erërave dhe përhapja e insekteve nga këta lumenj vështirëson jetën e përditshme të qytetarëve. Komuna nuk ka arritur të minimizojë rrezikun e daljes nga shtrati të këtyre lumenjve, gjatë të reshurave, ku në të kaluarën një numër shtëpish kanë pësuar dëme nga vërshimet.

Gjatë dy viteve të kaluara komuna nuk ka arritur të bëjë investime esenciale në zgjerimin e ndriçimit publik. Përgjithësisht, investimet në këtë aspekt janë fokusuar në mirëmbajtjen e rrjetit ekzistues të ndriçimit.

Problematikë tjetër në komunën e Vitisë paraqet edhe menaxhimi i mbeturinave në qytet. Në fillim të vitit 2010, komuna kishte marrur vendim për të themeluar një ndërmarrje komunale për menaxhimin e mbeturinave, vendim i cili ishte shpallur i jashtëligjshëm nga ana e Ministrisë së Administrimit të Pushtetit lokal (MAPL). Aktualisht, menaxhimin e mbeturinave në Viti e bënë një kompani regjionale me seli në Gjilan. Cilësia e shërbimeve brenda qytetit vlerësohet përgjithësisht e kënaqshme, por kjo nuk mund të thuhet edhe për fshatra ku pjesa dërrmuese e tyre nuk mbulohen nga ana e “Ekoregjionit”. Në këtë mënyrë, kjo po ndikon në krijimin e deponive të egra mbeturinash dhe hedhjen e tyre vend e pa vend. Së fundmi, udhëheqja komunale ka aprovuar vendimin me të cilin kushtëzohen qytetaret me pagesën e mbeturinave në këmbim të ofrimit të shërbimeve komunale. Ky vendim është përcjellur me pakënaqësi nga ana e qytetarëve të cilët aludojnë që ky kushtëzim është i padrejtë dhe e thëllon hendekun social të tyre. Kjo ka shtyrë MAPL-në që të shpall të paligjshme këtë vendim komunal, por Komuna e Vitisë ende mban në fuqi këtë vendim.

Komuna e Vitisë përballet edhe me mungesë të pronës komunale, gjë e cila shpesh here i vonon dhe problematizon nismat e komunës për investime. Kjo ka shkaktuar edhe mospajtime të thella me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (AKP) dhe me gjykatat. Pronat që ishin nën administrim të AKP-së, Komuna e Vitisë i trajtonte si prona komunale dhe nuk i përfillte vendimet e gjykatave për këto çështje. Në fund të vitit 2009, Nexhmedin Arifi dhe rreth 70 zyrtar të komunës arrestohen nga policia për shkak të kundërshtimit të ekzekutimit të vendimit të gjykatës. Gjykata kishte urdhëruar drejtorinë komunale të arsimit që të liroj objektin ku ishte vendosur për shkak se ajo i takonte Shoqatës së Gjahtarëve, por komuna kishte kundërshtuar. Pas largimit me forcë, objekti i cili sipas vendimit të gjykatës do të duhej t’i takonte shoqatës, shkatërrohet nga një mjet shpërthyes. Autorët e këtij akti ende nuk janë zbuluar.

## **2. Performanca buxhetore e Komunës së Vitisë**

Shkalla e të hyrave komunale në Viti ka shënuar rënie të ndjeshme në krahasim me vitet paraprake. Krahas rënies së të hyrave komunale, është shënuar rritje e ndjeshme e shpenzimeve të parasë publike në kategorinë e mallrave dhe shërbimeve, veçmas në darka dhe dreka zyrtare, udhëtime, mëditje, telefon si dhe në shpenzimet komunale.

Tabela nr.1: Shkalla e të hyrave komunale 2009-2011

Viti	Shuma (Euro)
2009	750.000
2010	802.000
2011	783.000 <sup>3</sup>
2012	840.000 <sup>4</sup>

Nga tabela e mësipërme shihet se të hyrat komunale mes vitit 2010 dhe 2011 kanë shënuar rënie për rreth 19.000 euro.

Tabela nr.2: Buxheti total i Komunës së Vitisë për vitin 2011

Përshkrimi	Shuma (Euro)
Investime kapitale	1.928.335,36
Subvencione	494.382
Mallra dhe shërbime	764.861,30
Shpenzime komunale	202.078
Paga dhe mëditje	5.265,407
<b>Gjithsejtë</b>	<b>8.655.063,66</b>

Nga të dhënat e mësipërme tregohet se Komuna e Vitisë gjatë një viti ka në dispozicion mbi 764.000 euro për kategorinë e mallrave dhe shërbimeve. Nëse e krahasojmë Komunën e Vitisë me komunitat e tjera të përfaqësuara, atëherë rezulton se kjo komunë ka dukshëm më shumë buxhet për mallra dhe shërbime se sa komuna të tjera si Kaçaniku, Rahoveci, Istogu, Deçani, Graçanica, Skenderaj, Kamenica dhe Klina.

Komuna e Vitisë ka një trend relativisht të lartë të shpenzimit të parasë publike në linjën e buxhetit për mallra dhe shërbime. Nga të dhënat si më poshtë, rezulton se këto shpenzime në vitin e fundit (2011) kanë shënuar rritje të konsiderueshme krahasuar me vitet paraprake.

Tabela nr.3: Disa nga shpenzimet në kategorinë e mallrave dhe shërbimeve në Komunën e Vitisë gjatë vitit 2011

Kategoria	Shuma (euro)
Shpenzimet e udhëtimit brenda vendit	31.608,82
Shpenzimet e udhëtimit jashtë vendit/akomodim	4.959
Avanc për udhëtime jashtë vendit	8.942,44

<sup>3</sup>Në shumën totale të të hyrave komunale për vitin 2011 nuk janë të përfshira edhe donacionet dhe participimi financiar i qytetarëve në projektet e ndryshme. Komuna e Vitisë i ka përfshirë këto dy kategori në të hyra komunale. Participimi i qytetarëve ka qenë në vlerën e 71.235 euro, ndërsa donacionet në vlerën e 46.155 euro, së bashku me shifrën e të hyrave, rezulton në shumën prej 900.390 euro.

<sup>4</sup>Të planifikuara për vitin 2012.

Mëditje për udhëtime jashtë vendit	2.573,20
Shpenzime të telefonisë fikse	16.473
Naftë për ngrohje qendrore	19.012
Blerje të thëngjillit/druve	99.327,25
Derivate për gjenerator	3.329
Karburante për vetura	78.868,68
Mirëmbajtja dhe riparimi i automjeteve	23.636,20
Shpenzime në telefoninë 'Vala'	14.345,77
Dreka zyrtare	29.822,47
Ushqim dhe pije - jashtë drekave zyrtare	18.725
Furnizim për zyre	73.668,71

Nga tabela e mësipërme vërehen shuma të konsiderueshme të parave të shpenzuara në linjën e mallërave dhe shërbimeve, përkatësisht për udhëtime brenda dhe jashtë vendit. Gjatë periudhës së vitit të kaluar, për akomodim, mëditje dhe avanc (për udhëtime) rezultojnë të shpenzuara mbi 48.000 euro, pastaj për telefon fiks dhe mobil afro 31.000 euro, për dreka dhe darka zyrtare si dhe për ushqim e pije afro 49.000 euro, ndërsa derivate për gjenerator, ngrohje qendrore dhe për vetura zyrtare rezultojnë të shpenzuara mbi 101.000 euro.

Tabela nr.4: Disa nga shpenzimet në kategorinë e mallrave dhe shërbimeve në Komunën e Vitisë gjatë vitit 2009 dhe 2010

Kategoria	Shuma (euro)	
	2010	2009
Shpenzimet e udhëtimit brenda vendit	16.198,20	12.058
Shpenzimet e udhëtimit jashtë vendit/akomodim	6.524	9.134
Avanc për udhëtime jashtë vendit	9.434	2.365
Shpenzime të telefonisë fikse	17.410,46	- <sup>5</sup>
Naftë për ngrohje qendrore	24.930	23.635
Blerje të thëngjillit/druve	100.579,20	64.555
Derivate për gjenerator	3.450	8.275
Karburante për vetura	61.649,20	47.443
Mirëmbajtja dhe riparimi i automjeteve	17.058	18.031
Shpenzime në telefoninë 'Vala'	12.963,78	9.810
Dreka zyrtare	33.431,21	- <sup>6</sup>
Ushqim dhe pije - jashtë drekave zyrtare	23.841,16	26.455
Furnizim për zyre	92.554,42	38.007

<sup>5</sup> Mungojnë të dhënat zyrtare.

<sup>6</sup> Mungojnë të dhënat zyrtare.



Krahasimi i të dhënave të mësipërme mes vitit 2011 dhe 2010, rezulton në rritje të ndjeshme të shpenzimeve në disa kategori. Kështu, shpenzimet për udhëtime brenda vendit gjatë vitit 2010 janë bërë mbi 16.000 euro, ndërsa në vitin 2011 mbi 31.000 euro, duke rezultuar kështu me një rritje prej afro 15.000 eurove. Karburant për vetura në vitin 2010 nga Komuna e Vitisë janë shpenzuar mbi 61.000 euro, ndërsa në vitin 2011 mbi 78.000 euro, apo 17.000 euro më shumë se sa në vitin 2010. Rritje të ndjeshme ka edhe në kategorinë e riparimit dhe mirëmbajtjes së automjeteve zyrtare si dhe furnizim për zyre. Shpenzime të përafërta mes vitit 2010 dhe atij 2011 janë hasur për telefon mobil dhe fiks, dreka dhe darka zyrtare, ushqim dhe pije, blerje e thëngjillit dhe druve për ngrohje, si dhe në udhëtime zyrtare jashtë vendit.

Komuna e Vitisë në skemën e saj buxhetore e ka të përfshirë kategorinë e avancit për udhëtime zyrtare, kategori kjo që nuk haset në linjën e buxhetit të komunave tjera në vend. Në skemën e buxhetit të Vitisë figuron e ndarë kategoria - shpenzime për mëditje jashtë vendit nga kategoria - shpenzime për avancet e shfrytëzuara për udhëtime jashtë vendit. Gjatë vitit 2011, komuna e Vitisë ka shpenzuar 8.942,44 euro si avance për udhëtime jashtë vendit, ndërsa një vit më heret 9.434 euro.

Vitia ka borxh relativisht të lartë publik gjatë dy viteve të fundit, por shkalla e këtij borxhi përgjithësisht vlerësohet e përbalueshme nga pikëpamja e kapacitetit buxhetor që ka komuna. Viti 2012 ka nisur nga autoritetet lokale të Vitisë me gjithsejtë 111.276 euro fatura të papaguara ndaj operatorëve privat, përderisa një vit më heret, shkalla e borxhit ka qenë 201.667 euro. Ky borxh evidentohet edhe në raportin e fundit të Auditorit të Përgjithshëm, i cili hapin e udhëheqsisë së komunës për të hyrë në obligime pa mbulesë financiare, e klasifikon si shpërfillje të normave ligjore.

Tabela nr.5: Disa nga shpenzimet në kategorinë e mallrave dhe shërbimeve në Komunën e Vitisë gjatë periudhës janar - mars 2012

Kategoria	Shuma (euro)
Shpenzime të telefonisë fikse	2.118
Naftë për ngrohje qendrore	4.086
Derivate për gjenerator	2.548
Karburante për vetura	16.141
Shpenzime në telefoninë 'Vala'	4.150
Dreka zyrtare	6.201

Tabela nr.6: Disa nga shpenzimet tjera në kategorinë e mallrave dhe shërbimeve në Komunën e Vitisë gjatë vitit 2011 dhe krahasimi i tyre me vitin 2010

Kategoria	Shuma (euro)	
	2011	2010
Pagesa për shërbime teknike	3.016	900

Pagesa ndaj shërbimeve kontraktuese tjera <sup>7</sup>	38.489	30.302,15
Pagesa për shpenzimin e rrymes	95.517,47	94.566,73
Pagesa për shpenzimin e ujit	36.902,70	33.158,67
Pagesa për mbeturina	34.047,72	53.949,50
Pagesa për furnizim me veshmbathje	26.321,50	10.134,20
Pagesa për mirëmbajtjen e ndërtesave dhe shkollave	87.429,71	45.627,65
Pagesa për mirëmbajtjen e teknologjisë informative	4.239,90	7.098,10
Pagesa për publikime dhe botime	19.314,80	12.230,68
Pagesa për informim publik	7.882,70	4.141,28
Pagesa për reklama dhe konkurse	1.494	306

Raporti i Auditorit të Përgjithshëm për vitin 2011, specifikon disa parregullsi të cilat ndikojnë negativisht në menaxhimin efikas financiar në Komunën e Vitisë. Sipas këtij raporti, komuna e Vitisë nuk ka zbatuar një sistem gjithëpërfshirës dhe automatik të faturimit dhe nuk mirëmban nën-llogari ose lista të ndara për të gjithë borxhlinjtë në lidhje me tatime të ndryshme. Edhe pse të arkëtueshmet kërkohet të jenë të shpalosura, nuk është bërë një shpalosje e tillë në pasqyrat financiare të komunës. Mungesa e korrektësisë do të ndikojë në të hyrat që mund të fitojë komuna, dhe mundësinë të përgatisë buxhet të besueshëm dhe të duhur, të raportoje mbledhjet e tatimit të duhur, dhe të monitorojë mbledhjen e të hyrave vetanake në baza kohore.<sup>8</sup> Sipas të njëjtit raport, Komuna e Vitisë nuk e ka të qartë numrin e plotë të bizneseve aktive në territorin e saj. Në mënyrë të drejtpërdrejt, kjo ndikon në shkallën e përgjithshme të të hyrave komunale, ngase bizneset e hapura rishtas nuk tatimohen, ndërsa bizneset që kanë shuar veprimtarinë mund të vazhdojnë të tatimohen.

### 3. Investimet kapitale

Gjatë viteve 2010-2011, investimet kapitale në Viti kanë pasur për fokus kryesisht rregullimin dhe asfaltimin e rrugëve, instalimin e rrjetit të kanalizimit dhe shtrirjen e rrjetit të ujësjellësit. Shuma e përgjithshme e mjeteve që ka në dispozicion komuna e Vitisë për investime kapitale gjatë një viti sillet rreth dy milion euro.

<sup>7</sup> Nuk specifikohet në skemën e buxhetit natyra dhe lloji i shërbimit.

<sup>8</sup> Zyra e Auditorit të Përgjithshëm. Raport

[http://www.oagrks.org/repository/docs/Vitia\\_31\\_12\\_2011\\_Final\\_alb\\_940014.pdf](http://www.oagrks.org/repository/docs/Vitia_31_12_2011_Final_alb_940014.pdf)

Në tabelën nr.7: Disa nga investimet kapitale të Komunës së Vitisë të realizuara gjatë vitit 2011

<b>Projektet kryesore të realizuara gjatë vitit 2011</b>	<b>Shuma (euro)</b>
Asfaltimi i rrugës Gjylekarë-Remnik	36.438,50
Asfaltimi rrugës "Elena Gjika"	31.989,83
Asfaltimi i rrugës së lagjes "Halabaku" në Pozheran	22.247,35
Rregullimi i trotuareve nga rruga Halabaku- deri te përmendorja në Pozhoran.	72.645,00
Rregullimi i ujësjellësit dhe sheshit të fshatit Letnicë	14.707,18
Shtruarja e rrugës me zhavor Buzovik -Kolishtë	19.795,00
Rregullimi i sheshit në fshatin Letnicë	13.529,25
Shtruarja me zhavor e rrugës Tërpezë-Ballancë	13.825,00
Zgjerimi dhe rregullimi i trotuareve nga ura deri të shtëpia e shëndetit	59.514,98
Zgjerimi dhe rregullimi në rrugën "2 Korriku" dhe "Tirana"	98.790,26
Ndërtimi dhe asfaltimi i rrugës "Sherif Frangu" dhe "Korqa" -faza e dytë	22.320,00
Ndërtimi i kanalizimit në fshatin Kabash	84.765,82
Ndërtimi i kanalizimit në fshatin Sadovinë e Jerlive	20.770,76
Ndërtimi i kanalizimit në fshatin-Radivojcë 'faza e dytë'	49.231,77
Ndërtimi i urave në fshatin Zhiti	34.075,00
Ngjyrosja e ndërtesave në qendër të qytetit	38.880,90

Investimet kapitale në Komunën e Vitisë janë manifestuar në disa raste me dëmtimin e infrastrukturës, pak kohë pas finalizimit të punimeve. Kjo do të duhet të shërbente si indikacion i mjaftueshëm për autoritetet lokale që në të ardhmen t'i forcojnë mekanizmat e kontrollimit të cilësisë së punimeve. Përgjithësisht në rrugët e asfaltuara në Viti hasen gropat dhe dëmtimet tjera përcjellëse.

Shuma të mëdha parash shpenzohen nga Komuna e Vitisë në rregullimin e rrugëve me zhavor, praktikë kjo që nuk ka rezultuar e suksesshme, ngase kërkesa e banorëve është që rrugët të asfaltohen dhe jo të meremetohen përkohësisht. Gjatë dimrit të kaluar (janar-shkurt 2012), rrugët që kanë qenë me zhavor janë kthyer në gjendjen e mëparshme nga përpjekjet e ekskavatorëve për heqjen e bores nga rrugët.

Në tabelën nr.8: Disa nga investimet kapitale të Komunës së Vitisë të realizuara gjatë vitit 2010

Projektet kryesore të realizuara gjatë vitit 2010	Shuma (euro)
Asfaltimi, rregullimi i trotuarit dhe ndriçimi i rrugës "Iliria" në Viti	79,985.97
Rregullimi trotuareve, kanalizimeve dhe asfaltimi i rrugëve "2 Korriku" dhe "Hoxhë Jonuzi"	142,733.70
Ndërtimi i kanalit të hapur dhe ndërtimi i rrugës "Kongresi i Manastirit"	58,887.00
Rregullimi i kanalizimit në fshatin Radivojcë	48,218.00
Rregullimi i fushës sportive - Sllatina e Poshtme	9,806.02
Rregullimi i trotuareve dhe kanalizimit në të dy anët e rrugës - Pozhoran	89.538,00
Zgjerimi i rrugës dhe i rrethit - Pozhoran	20.188,90
Asfaltimi i rrugës Stubëll e Epërme-Goden	1

#### 4. Aktivitetet e Prokurimit Publik 2010 - 2011

Zyra e Prokurimit në Komunën e Vitisë, sipas organogramit, funksionon në kuadër të Drejtorisë së Administratës dhe ka një të punësuar në pozitën e menaxherit të prokurimit. Për dy vite (2010-2011), komuna e Vitisë ka lidhur 185 kontrata në vlerë të përgjithshme mbi 3.5 milionë euro nëpërmjet procedurave të prokurimit.

Tabela nr.9: Kontratat e Prokurimit në Komunën e Vitisë

Viti	Nr. i kontratave	Vlera e kontratave (Euro)
2010	88	1.600.101,19
2011	97	2.095.629,42
<b>Totali</b>	<b>185</b>	<b>3.695.730,61</b>

Burimi: KRPP Raporti për 2010 dhe 2011

Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP), ka dënuar Komunën e Vitisë gjatë vitit 2011 në shumën e 10.000 eurove për shkak të shpërfilljes së një rekomandimi të kësaj instance lidhur me procesin e prokurimit i iniciuar për rindërtimin e murit të shkollës fillore "Hasan Aliu". Pas ankesave nga njëri prej operatorëve ekonomik, OSHP vendosi që vlerësimi i kërkesave është i nevojshëm dhe konkluzioni i tyre ishte se tenderi duhej të anulohet si pasojë e mungesës së ofertuesve përgjegjës. Komuna e Vitisë ka anuluar tenderin dhe pas rishpalljes i ka dhenë të njëjtin tender kompanisë paraprake që ka fituar në tenderin e parë. Njeri nga operatorët ekonomik sërish i është adresuar OSHP-së dhe vendimi i tyre ishte që komuna duhet të themelojë një komision profesional për vlerësim. Departamenti i prokurimit nuk e ka përfillur këtë vendim. Si pasojë, OSHP

vendosi të ngarkojë komunën e Vitisë me 10.000 euro gjobë dhe rekomandoi Kryetarin të ndërmerr masa kundër zyrtarit të prokurimit dhe komisionit për vlerësim dhe të respektoj vendimin paraprak të OSHP për rivlerësim të ofertave nga komisioni profesional. Kryetari nuk ka ndërmarr asnjë masë pas gjobës së aprovuar nga ana e OSHP-së dhe kërkesës së saj që të ndërmerren masa ndëshkuese ndaj përgjegjësit të Zyrës së Prokurimit.<sup>9</sup>

Autoritetet lokale në Viti do të duhej të ndërmerrnin masa shumë më serioze në pamundësimin e rasteve të konfliktit të interesit. Ka raste kur zyrtarët e lartë të komunës së Vitisë përfaqësojnë apo janë të ndërlidhura me firma private me të cilat arrijnë të tërheqin tender për ofrimin e shërbimeve për nevojat e komunës. Firma “Eleganca”, me pronar Gafurr Arifin, djalin e axhës së Nexhmedin Arifit, ka marrë kontratë për ndërtimin e shkollës në Sllatinë të Epërme, në vlerë 104.386 euro.<sup>10</sup> Po ashtu, pronarët e ndërmarrjeve “Diellza ipex” dhe “Ermali com”, me pronar Muhabi e Faruk Zuka, dhëndërr, përkatësisht nip i Nexhmedin Arifit, marrin kontrata të rregullta. Sipas të dhënave, këto ndërmarrje nga mesi i vitit 2008 deri më tani kanë fituar kontrata në vlerë prej 95.304 euro. Lloji i shërbimeve të ofruara nga këto ndërmarrje është i ndryshëm dhe përfshinë nga furnizimi me pije dhe artikuj ushqimor deri në furnizimin me stufa, ndonëse si veprimtari kryesore këto ndërmarrje kanë tregtinë me teknikë të bardhë.<sup>11</sup> Besim Halimi, anëtar i kryesisë së degës së PDK-së në Viti, dhe aktualisht shef i administratës dhe personelit, përmes ndërmarrjes së tij “Shpëtimi”, ka fituar kontratën furnizim me pije dhe artikuj ushqimor në vlerë prej 35.702 euro.<sup>12</sup> Anëtar i tjetër i Kryesisë së degës së PDK-së në këtë komunë, Gasper Demaj, njëherit edhe drejtor i shkollës së mesme “Kuvendi i Lezhës” në Viti, përmes ndërmarrjes së tij “Gapi” ka fituar dy kontrata, me vlerë të përgjithshme prej 24.157 euro.<sup>13</sup>

Kompania INSI, me përfaqësues Sylejman Berisha, i cili në zgjedhjet e fundit lokale ka qenë pjesë e garës për Kuvendin Komunal të Vitisë në listën e PDK-së, ka fituar kontratën në vlerë prej 49.185 eurove për Hartimin e Planit Rregullues Urban.<sup>14</sup>

Komuna e Vitisë i ka dhënë kontratë N.N.P “Area” sh.p.k nga Hodonoci i Kamenicës në vlerë prej 83.087 eurove. Kontrata kishte të bënte me rregullimin e parkut në

---

<sup>9</sup> Zyra e Auditorit të Përgjithshëm [http://www.oag-rks.org/repository/docs/Vitia\\_31\\_12\\_2011\\_Final\\_alb\\_940014.pdf](http://www.oag-rks.org/repository/docs/Vitia_31_12_2011_Final_alb_940014.pdf)

<sup>10</sup> Pasqyrat financiare të buxhetit të Komunës së Vitisë Janar-Dhjetor 2011. Fq 22

<sup>11</sup> [http://krpp.rks-gov.net/Default.aspx?PID=Notices&LID=1&PCID=-1&CtlID=SearchNotices&stat=2&PPRCMenu\\_OpenNode=114](http://krpp.rks-gov.net/Default.aspx?PID=Notices&LID=1&PCID=-1&CtlID=SearchNotices&stat=2&PPRCMenu_OpenNode=114)

<sup>12</sup> <http://krpp.rks-gov.net/Default.aspx?PID=Notices&LID=1&PCID=-1&CtlID=ViewNotices&ID=32359>

<sup>13</sup> [http://krpp.rks-gov.net/Default.aspx?PID=Notices&LID=1&PCID=-1&CtlID=SearchNotices&stat=2&PPRCMenu\\_OpenNode=114](http://krpp.rks-gov.net/Default.aspx?PID=Notices&LID=1&PCID=-1&CtlID=SearchNotices&stat=2&PPRCMenu_OpenNode=114)

<sup>14</sup> <http://krpp.rks-gov.net/Default.aspx?PID=Notices&LID=1&PCID=-1&CtlID=ViewNotices&ID=51720>

Pozheran. Në këtë lokalitet nuk ka park.<sup>15</sup> Njoftimet janë kontradiktore sepse rreth këtij rasti, njoftohet se ka pasur disa probleme për shkak se komuna kishte insistuar ta ndërtoj këtë park në një pronë, që rezulton të jetë private. Pronarët e kësaj prone private në Pozheran, aludojnë se Kryetari Arifi ka bërë përpjekje të tjetërsimit të kësaj prone me qëllim të eliminimit të konkurrencës për bizneset e shefit të tij të administratës dhe personelit, Besim Halimi, që gjendet përballë këtij lokali.

E konsideuar si e afërt me PDK-në dhe kryetarin Nexhmedin Arifi, kompania “Euroabi”, me pronar Kadrush Rexhepi, ka fituar kontrata nga Komuna e Vitisë. Vetëm kontrata për mirëmbajtje të rrugëve gjatë dimrit, për një vit kap shifrën prej 280.350 eurove.<sup>16</sup> Periudha e dhënies së kontratës (31 Dhjetor 2009), korrespondon me periudhën e rizgjedhjes së z. Arifi dhe kjo konsiderohet në Viti si kthim i borgjit të financimit të fushatës.

## 5. Administrata e Komunës së Vitisë

Numri i përgjithshëm i të punësuarve në Komunën e Vitisë është 189 persona duke mos përfshirë këtu edhe të punësuarit në sektorin e arsimit dhe shëndetësisë. Së bashku me këta dy sektorë e fundit, numri i përgjithshëm i të punësuarve është gjithsejtë 1.098 të punësuar.

Karakteristikë e hasur në administratën e Komunës së Vitisë është përfaqësimi tejet i vogël i femrave. Asnjë nga drejtoritë komunale nuk udhëhiqet nga femrat. Nga gjithsejtë 189 të punësuarve në Komunën e Vitisë, vetëm 21 janë femra, ndërsa 168 janë meshkuj. Kjo është në kundërshtim me Ligjin për Barazi Gjinore, ku specifikohet së çdo institucion ka për obligim të siguroj pjesëmarrjen e femrave në kuotën e 40% në administratë apo në dikasteret tjerë brenda institucionit.<sup>17</sup>

Tabela nr.10: Numri i të punësuarve sipas sektorëve në Komunën e Vitisë

Sektorët	Numri i të punësuarve
Zyra e Kryetarit	18
Drejtoria e Administratës	39

<sup>15</sup> Në një njoftim anulimi të KRPP-së dt 25 janar 2010 thotë se ka pasur anulim të kësaj kontrate për shkak të ngjarjeve dhe/apo arsyeve objektive dhe të demonstrueshme të cilat kanë qenë të paparashikueshme në kohën e inicimit të aktivitetit të prokurimit, por data janë të papërputhshme. Në formular shkruan se anulimi i kësaj kontrate është bërë me 24.06.2010, saksisht një vit më vonë, Sipas ligjit të gjitha aktivitetet financiare duhet të përmbillen brenda vitit kalendarik.

<sup>16</sup> <http://krpp.rks-gov.net/Default.aspx?PID=Notices&LID=1&PCID=-1&CtlID=ViewNotices&ID=26552>

<sup>17</sup>Neni 3.2 i Ligjit për Barazi Gjinore. Burimi:

[http://www.assemblykosova.org/common/docs/ligjet/2004\\_2\\_al.pdf](http://www.assemblykosova.org/common/docs/ligjet/2004_2_al.pdf)

Drejtoria për Buxhet dhe financa	23
Drejtoria për Gjeodezi dhe Kadaster	9
Drejtoria e Planifikimit urban	6
Drejtoria për Bujqësi dhe zhvillim rural	5
Sektori i Arsimit	776
Drejtoria e Arsimit	6
Sektori i Shëndetësisë	133
Drejtoria e Shërbimeve publike	6
Zjarrfikës	26
Drejtoria për Kulturë-Rini dhe sport	13
Drejtoria e Shëndetësisë	5
Drejtoria e Inspektionit	13
Qendra komunale për pylltari	10
Qendra për Punë Sociale	10
<b>Gjithsejtë</b>	<b>1.098</b>

Keqësimi dhe ndërprerja e raporteve në mes Kryetarit të Komunës, Nexhmedin Arifi dhe degës së PDK-së në Viti, ka rezultuar edhe me punësime dhe largime nga vendi i punës brenda komunës, varësisht nga pozicionet e mbajtura për apo kundër degës së PDK në Viti.

Daut Xhemajli e Xhevat Bislimi, udhëheqës aktual të degës së PDK-së në Viti, kritikojnë publikisht Nexhmedin Arifin se ka larguar ose ka suspenduar njerëz nga puna, vetëm se nuk ishin pjesë e politikës së tij. Këta persona janë: Halim Halilin, nënkryetar, Selvije Rexhepin, drejtoreshë për buxhet dhe financa, Avdulla Eminin, menaxher i prokurimit, Habib Halilin, shef i gjendjes civile dhe Fevzi Mehmetin, auditor i brendshëm i komunës së Vitisë. Për këtë të fundit, Këshilli i Pavarur Mbikqyrës ka vendosur në favor të tij dhe ai duhet të kthehet në vendin e punës.

Kryetari i Sindikatës së Shërbyesve Civil, Agim Sylejmani, ka qenë udhëheqës i zyrës ligjore. I njejtë udhëheq komisionin diciplinor të komunës së Vitisë. Në vend se të mbrojë shërbyesit civil, z.Sylejmani akuzohet se ndëshkon ata sipas direktivave të kryetarit Arifi. Opozita dhe grupi kundërshtar i PDK-së e konsiderojnë këtë si mjet i kontrollit arbitrar të shërbyesve civil nga ana e kryetarit Arifi.

Nexhmedin Arifi akuzohet se pa respektuar procedurat, dhe në mënyrë arbitrare, ka transferuar nga arsimit, ku ka punuar si e pakualifikuar në Bibliotekën e Qytetit, gruan e mikut të tij Nazim Dautit, ish-drejtor i Shtëpisë së Shëndetit në Viti. Për më shumë z. Arifi kritikohet që me para të komunës ka mundësuar specializimin e dytë 5 vjeçar për Radiologji të Nazim Dautit.

## 6. Arsimi në Komunën e Vitisë

Në Komunën e Vitisë funksionojnë 35 shkolla fillore, katër shkolla të mesme dhe një çerdhe.

Tabela nr.11: Numri i mësimdhënësve dhe stafi përcjellës në 35 shkollat fillore të Vitisë:

Gjinia	Numri i mësimdhënësve	Stafi ndihmës
Femra	224	8
Meshkuj	304	71
<b>Gjithsejtë</b>	528	79

Tabela nr.12: Numri i mësimdhënësve dhe stafi përcjellës në shkollat e mesme të Vitisë

Gjinia	Numri i mësimdhënësve	Stafi ndihmës
Femra	30	5
Meshkuj	118	16
<b>Gjithsejtë</b>	148	21

Tabela nr.13: Numri total i mësimdhënësve, nxënësve dhe stafit ndihmës në 35 shkolla fillore dhe katër shkolla të mesme në Komunën e Vitisë

Kategoria	Numri	F	M
Mësimdhënës	676	254	422
Nxënës	11.758	5.624	6.134
Stafi ndihmës	100	13	87

Nexhmedin Arifi dhe Drejtori i tij për Arsim, Fehri Qerimi, kritikohen se kanë keqpërdorur pozitën e tyre për punësime pa kriter profesional, dhe me arbitrazim në fushën e arsimit. z.Qerimi në emër të vendosjes së rregullit dhe diciplinës ka bërë ndërrime të shpeshta të vendeve të punës. Po ashtu, ai akuzohet edhe për mos respekt ndaj mësimdhënësve të Komunës së Vitisë. Së paku në një rast ai është sulmuar edhe fizikisht. Pas fyerjeve të ndërsjella, në objektin e shkollës së mesme "Kuvendi i Lezhës", paralelet në Pozheran, është përleshur me Fadil Ramiqin, ish Drejtor i Kulturës gjatë qeverisjes së LDK-së dhe mësimdhënës në këtë shkollë. Pas këtij akti z.Ramiqi është suspenduar dhe rasti është në procedurë gjyqësore.

Valbona Halimi, bashkshortja e Besim Halimit, shefit të administratës dhe personelit, vazhdon të mbaj pozitën e drejtoreshës së shkollës fillore "Halil Alidema" në Pozheran,



përkundër faktit që nuk posedon kualifikimin universitar siq e kërkon ligji, përkatësisht Udhëzimi Administrativ i MASHT-it.<sup>18</sup>

## 7. Shëndetësia në Komunën e Vitisë

Në komunën e Vitisë funksionon një Qendër Kryesore e Mjekësisë Familjare (QKMF), katër Qendra të Mjekësisë Familjare (QMF), dhe shtatë njësi shëndetësore apo ambulanca. QKMF funksionon në qendër të qytetit, ndërsa QMF-të, një gjendet në fshatrat Pozhoran, Sadovinë, Smirë dhe Sllatinë. Njësitë shëndetësore janë në fshatin Skifter, Terpezë, Letincë, Zhiti, Remnik, Stubell dhe Beguncë. Numri i të punësuarve në sektorin e shëndetësisë në Komunën e Vitisë është gjithsej 133, dhe pjesa dërmuese e tyre janë në QKMF. Sistemi i shëndetësisë në Komunën e Vitisë është i ndarë në reparte dhe funksionojnë gjithsejtë pesë reparte të tilla, konkretisht, reparti i emergjencave, reparti i mjekësisë familjare, i stomatologjisë, maternitetit dhe reparti i vaksinimit.

Tabela nr.14: Numri dhe pozitat e të punësuarave në sistemin e shëndetësisë në Viti

Stafi i QKMF	Numri
Mjek të përgjithshëm	12
Motra medicinale	14
Stomatolog	3
Infermier	59
Specialist të mjekësisë familjare	8
Vozitës	3
Shef i shërbimit	3
Koordinator për cilësi	2
Pastrues	4
Rojtar	3
Depoist/arkivist	2
Mami	3
Administratë	11
Laborant	4
Drejtori/zëvendës	2
<b>Gjithsejtë</b>	<b>133</b>

<sup>18</sup> Udhëzimi Administrativ për Procedurat e zgjedhjes së drejtorit të institucioneve edukativo-arsimore dhe aftësuese 3/2009 të dt 09.02.2009, neni 3.

## 8. Transparenca

Zyra për Informim në Komunën e Vitisë funksionon brenda Zyrës së Kryetarit dhe ka gjithsejtë dy të punësuar. Së fundmi komuna e Vitisë ka angazhuar edhe një person brenda zyrës për informim i cili është i ngarkuar për t'i menaxhuar kërkesat për qasje në dokumentet zyrtare. Vitia ka një radiotelevizion lokal "Iliria" dhe një radio lokale "Zëri i Pozheranit". Këto media nuk kanë kapacitete profesionale dhe financiare për të bërë pasqyrime gjithëpërfshirëse. Kjo komunë mbulohet herë pas herë nga mediumet e shkruara. Faqja zyrtare e kësaj komune ka informata bazike në lidhje me komunën dhe zhvillimet e përditshme, por janë të pamjaftueshme sasia e dokumenteve që mund të hasen në këtë faqe, përjashtimisht pasqyrimin shumë të detajuar të aktiviteteve të Kryetarit të komunës dhe agjendës së tij.

Tabela nr.15: Vlerësim i përmbajtjes së ueb faqes së Komunës së Vitisë

<http://kk.rks-gov.net/viti/>

Dokumenti	2010				2011				2012
	I	II	III	IV	I	II	III	IV	I
Raporti i Punës së Kryetarit	x	x	x	√	x	x	x	√	x
Raporti financiar i Komunës	x	x	x	√	x	x	x	√	x
Raportet e Drejtorisë së Administratës	x	x	x	x	x	x	x	x	x
Raportet e Drejtorisë së Arsimit	x	x	x	x	x	x	x	x	x
Raportet e Dr. së Shëndetësisë dhe Mir.Soc.	x	x	x	x	x	x	x	x	x
Raportet e Drejtorisë së Inspektionit	x	x	x	x	x	x	x	x	x
Financa, Ekonomi dhe Zhvillim	x	x	x	x	x	x	x	x	x
Urbanizmi, Kadastri dhe Mjedisi	x	x	x	x	x	x	x	x	x
Shërbimet Publike	x	x	x	x	x	x	x	x	x
Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural	x	x	x	x	x	x	x	x	x
Raportet dhe njoftimet e Zyrës së Prokurimit					√				
Raportet e Njesisë së Auditimit të Brendshëm					x				
Procesverbalet e Kuvendit Komunal	√				√				√
Rregulloret Komunale					√				
Vendimet e Kuvendit Komunal	√				√				√
Rregullorja e Punës së Kuvendit Komunal					x				
Procesverbalet e Komitetit për Politikë dhe Fina.	x	x	x	x	x	x	x	x	x
Planet dhe Strategjitë e Komunës					√				

X = mungon raporti.

√= raporti është i publikuar në ueb-faqe

## 9. Përmbushja e premtimeve të fushatës zgjedhore 2009

Gjatë fushatës zgjedhore të vitit 2009, kandidati për kryetar komune, tani Kryetari i Komunës z. Nexhmedin Arifi, para elektoratit të tij ka prezantuar 17 premtime për sfera të ndryshme. Pas monitorimit të të gjitha premtimeve të dala nga fushata zgjedhore, Instituti GAP dhe BIRN, në vitin 2010 i kanë shkruar letër të hapur Kryetarit të Komunës të cilit i'a përkujtuan edhe një herë premtimet e dhëna, duke kërkuar njëkohësisht edhe realizueshmërinë e tyre.

Tabela nr.16: vlerësohet progresi i arritur në realizueshmërinë e premtimeve të dhëna në 2009. Në këtë tabelë janë përfshirë 17 premtime të dhëna. Në bazë të hulumtimit të GAP del se pas dy viteve të qeverisjes në komunën së Vitisë, apo gjysmën e mandatit qeverisës, 3 premtime janë përmbushur, 9 nuk janë realizuar, ndërsa 5 premtime ka pasur nisma dhe rezultate evidente, por akoma nuk mund të vlerësohen të përmbyllura. (Shih tabelën e mëposhtme).

Premtimet	Realizueshmëria
Administratë efikase	Raporti i monitorimit të komunave të Republikës së Kosovës 2011 (fq. 83) të MAPL, administrata komunale e Vitisë <b>ka rënie të efikasitetit</b> . Për dallim nga viti 2010, ku kjo administratë ka shqyrtuar 94.99 % të kërkesave, në vitin 2011, kjo administratë ka shqyrtuar 76.46% të kërkesave.
Shërbime të mira shëndetësore	Ka pasur rezultate evidente në këtë drejtim, por shëndetësia në Komunën e Vitisë nuk dallon nga gjendja e përgjithshme në vend sa i përket këtij sektori.
Mbrojtje të mjedisit	Nuk ka pasur ndonjë nismë, projekt apo vendim përkatës komunal me qëllim të mbrojtjes së ambientit.
Zhvillimin e bujqësisë dhe blegtorisë	Nga projeksionet buxhetore nuk vërehet se komuna e Vitisë e ka trajtuar me prioritet bujqësinë dhe blegtorinë. Në vitin 2011, Drejtoria për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural që mbulon këtë sektor që përshinë një territor të tokës së punueshme prej rreth 6000 hektarësh, në buxhetin e saj ka pasur vetëm 150.000 euro, nga të cilat gjysma apo 75.000 kanë qenë në kategorinë paga dhe mëditje.

Investime në infrastrukturë rrugore, arsim, shëndetësi, rini dhe sport.	Ka pasur investime në të gjitha nga këto fusha, por jo ytë mjaftueshme për të bërë ndryshime të nevojshme.
Promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut	Në kuadër të zyrës së Kryetarit të komunës ekziston Njësia për drejtat e njeriut. Por nëse i'u referohemi shpenzimeve të gjykatave ku është detyruar kjo komunë të paguaj për shkeljet që ka bërë ndaj shërbyesve civil, dhe dy rasteve që kanë të bëjnë me pronat (Ëmbëltorja "Sharri" në Viti, me pronar një pjesëtar të komunitetit goran dhe "RIFATI" në Pozheran, me pronar Mifail Zuka), Nexhmedin Arifi ka vepruar në drejtimin e kundërt. Në të dy rastet komuna ka kontestuar pronësinë dhe ka vepruar arbitrarisht, duke e prishur "Sharri"-in, përkthësisht duke ndaluar punën për zgjerimin e objekteve të biznesit për NTP "RIFATI". Përderisa për rastin "SHARRI" procesi është në gjykatë dhe nëse provohet pronësia, komuna do të detyrohet të paguajë shuma të mëdha, ndërsa në rastin "RIFATI", komuna veç ka pranuar se ajo tashmë është në pronësi private.
Zhvillim ekonomik, si parakusht për tërheqjen e investitorëve dhe punësimin e të rinjve	Nëse zhvillimi ekonomik matet me numrin e investitorëve dhe vlerën e investimeve të tyre, në komunën e Vitisë nuk kemi arritur të gjejmë asnjë investitor të jashtëm që ka pasur ndikim në rritjen e punësimit. Të gjitha investimet gjatë kësaj periudhe në këtë komunë janë bërë nga biznesmen lokal, veprimtaria e të cilëve nuk vërehet që ka pasur ndikim në punësim.
Mbi 12 milion euro investime për vitin 2010	Sipas pasqyrave financiare, totali i investimeve kapitale për vitin 2010 në komunën e Vitisë ka qenë 1.749.438 euro. Shifra prej 12 milionëve e premtuar për investime është shumë larg të arrihet edhe nëse i shtojmë investimet për këtë komunë në vitin 2011, të cilat duke iu referuar të njëjtit raport kanë qenë 1.820.510 euro.
Përfundimin e punëve në kompleksin e varrezave të dëshmorëve	Premtim i përmbushur.

Ndërtimin e një zone industriale në fshatin Drobesh	Nuk është përmbushur ky premtim. Shumë pjesë të hapsirës ku ishte paraparë kjo zonë kanë rezultuar të jenë pronë private dhe projekti është bërë i parealizueshëm. Hulumtuesit nuk kanë vërejtur ndonjë përpjekje tjetër të institucioneve komunale për ta zhvendosur këtë projekt në ndonjë zonë tjetër.
Zbutjen e papunësisë duke promovuar bujqësinë	Vitia konsiderohet rajon bujqësor dhe me rendiment të lart të tokës, por jo aq sa për të ndikuar në zbutjen e papunësisë. Shumica e të rinjve të papunë të kësaj ane me të cilët kemi pas rastin të flasim, si alternativë e shohin ikjen jashtë shtetit, ku shumica e tyre shpresojnë se do të ndihmohen nga të afërmit që tashmë i kanë atje.
Ndërtimin e një dige e cila do të mundësojë sigurimin e ujit të pijshëm dhe ujitjen e 5,000 ha tokë	Përveç faktit që i janë transferuar 60.000 euro një kompanie fiktive, asgjë nuk vërehet që është bërë në këtë drejtim. Për më tepër, kjo çështje supozohet se është objekt hetimi i Krimeve Ekonomike dhe njëra nga çështjet për të cilat Nexhmedin Arifit do t'i duhet të jap përgjegjësi edhe para gjykatave.
Furnizimin e Komunës me rrymë elektrike, projekt veçse i nisur nga Qeveria Zvicerane që do të përfundoj brenda 2 viteve	Furnizimi me rrymë është përgjegjësi e KEK-ut dhe KOST-it dhe nuk është e qartë nëse komuna e Vitisë ka fituar ndonjë të drejtë ekskluzive nga Rregullatori i Energjisë për ta bërë këtë.
Ndërrimin e gypave të ujit në gjatësi prej 4 km në vlerë prej 1 milion euro (projekt i cili do të realizohet këtë mandat).	Nga biseda me disa banorë të zonës së Vitisë kemi mësuar se ky projekt nuk është realizuar dhe sa herë që vije uji pas ndërprerjes, është i papastër për shkak të gypave të vjetruar.
Evitimin e problemeve të kanalizimit	Ky premtim nuk është përmbushur. Si dëshmi, hulumtuesve të GAP-it i janë ofruar fotografi të përmytjes së qendrës së Vitisë me 18 prill të këtij viti.
Përfundimin e trotuarit në fshatin Pozheran dhe fshatra tjera	Në fshatin Pozheran ka pasur dy projekte për ndërtimin e trotuareve, ku në njërin dyshohet për keqpërdorime. Megjithatë, duket se është punuar në këtë drejtim, por këto projekte nuk e kanë përmbushur këtë premtim në tërësi. Trotualet e ndërtuara mbulojnë vetëm pjesën qendrore të këtij fshati që përshkohet nga magjistranja Gjilan-Ferizaj.
Përfundimin e palestrës sportive deri në përfundim të vitit 2010	Edhe ky premtim nuk është përmbushur. Madje, nuk është paraparë as me buxhetin e këtij viti dhe nuk ka asnjë projekt konkret.

## 10. Burimet:

1. Komuna e Vitisë. Raporti financiar janar – dhjetor 2010.
2. Komuna e Vitisë. Raporti financiar janar – dhjetor 2011.
3. Komuna e Vitisë. Raporti financiar janar – mars 2012.
4. Komuna e Vitisë. Raporti i punës se kryetarit për vitin 2010.
5. Komuna e Vitisë. Raporti i punës se kryetarit për vitin 2011.
6. Komuna e Vitisë. Skema e te punësuarve ne komune.
7. Komuna e Vitisë. Skema e te punësuarve ne arsimin fillor dhe te mesëm.
8. Komuna e Vitisë. Skema e te punësuarve ne sektorin e shëndetësisë.
9. Raporti Financiarë 2010 dhe Raporti Financiarë 2011 i Ministrise së Financave të Qeverisë së Kosovës. <http://mf.rks-gov.net/sq-al/ministriaefinancave/buxhetiirepublikessekosoves/buxhetiendrore.aspx>
10. Tabelat e Buxhetit te Kosoves per vitin 2011. <http://mf.rks-gov.net/sq-al/ministriaefinancave/buxhetiirepublikessekosoves/buxhetiendrore.aspx>
11. Raportet vjetore 2010 -2011 të Koomisionit Rregullativ të Prokurimit Publik - [http://krpp.rks-gov.net/Default.aspx?PID=Home&LID=1&PCID=-1&CtlID=HTMLStatic&CID=PPRCannual&PPRCMenu\\_OpenNode=90](http://krpp.rks-gov.net/Default.aspx?PID=Home&LID=1&PCID=-1&CtlID=HTMLStatic&CID=PPRCannual&PPRCMenu_OpenNode=90)
12. Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë. Statistikat e Arsimit në Kosovë 2011-2012. Burimi: <http://www.mashtgov.net/advCms/documents/11052012.pdf>
13. Zyra e Auditorit të Përgjithshëm. Raporti i Auditimit për Pasqyrat Financiare të Komunës së Vitisë. [http://www.oagrks.org/repository/docs/Vitia\\_31\\_12\\_2011\\_Final\\_alb\\_940014.pdf](http://www.oagrks.org/repository/docs/Vitia_31_12_2011_Final_alb_940014.pdf).
14. Web faqja e Komunës së Vitisë - <http://kk.rks-gov.net/viti/>
15. Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik. Njoftimet për lidhjen e kontratave përmes prokurimit publik nga Komuna e Vitisë. [http://krpp.rks-gov.net/Default.aspx?PID=Notices&LID=1&PCID=-1&CtlID=SearchNotices&stat=2&PPRCMenu\\_OpenNode=114](http://krpp.rks-gov.net/Default.aspx?PID=Notices&LID=1&PCID=-1&CtlID=SearchNotices&stat=2&PPRCMenu_OpenNode=114)